



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 115 Prot

Tiranë, më 30.08, 2013

VENDIM QARKULLUES Nr. 266, datë 30.08, 2013

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve **Vokopola 1, Vokopola 2, Vokopola 3**, në Lumin Vokopolë, (Komunat, Rrethi Berat) mbi bazën e kërkesës së Subjektit "VOKOPOLA ENERGJI" sh.p.k., Tiranë,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga **Agjencia e Shërbimit Arkeologjik** për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve **Vokopola 1, Vokopola 2, Vokopola 3**, në Lumin Vokopolë, (Komunat, Rrethi Berat), paraqitur nga Subjekti "VOKOPOLA ENERGJI" sh.p.k., Tiranë.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Berat bazuar në kontratën dypalëshe midis "VOKOPOLA ENERGJI" sh.p.k., dhe Agjencisë së **Shërbimit Arkeologjik**.
- III. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori ("VOKOPOLA ENERGJI" sh.p.k.) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Berat.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

VISAR ZHITI
MINISTËR

SEKRETAR I KKA
ROLAND OLLI

